

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga Shtime të cilin e përfaqëson av. [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ' [REDACTED] ' sh.a. me seli ne Prishtinë rr.' [REDACTED] ' nr. [REDACTED] për çështjen juridike rimbursim i mjeteve, vlera e objektit të kontestit 1,400.00€, jashtë seancës me datë 25.01.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

(Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia)

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Shtime, ushtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ' [REDACTED] ' sh.a., lidhur me çështjen juridike-civile rimbursim i mjeteve.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit av. [REDACTED] të tij me datë 05.02.2016, ka ushtruar padi kundër të paditurës për rimbursimin e mjeteve.

Përfaqësuesi i palës paditëse av. [REDACTED] me parashtrësën e datës 24.01.2018, e ka tërhequr kërkesëpadinë për faktin se nuk është i interesuar që të zhvilloj këtë procedure më tutje, pasi që e paditura me datën 17.08.2016 e ka bërë pagesën e mjeteve që janë objekt i kontestit të kësaj kërkesëpadie.

Procedura civile zhvillohet me vullnetin e palëve ndërgjyqëse. Parimi i disponibilitetit në procedurën civile është ndër ma kryesorit për zhvillimin dhe përfundimin e një çështjeje juridike civile. Sipas këtij parimi paditësit i njihet e drejta që procedurën civile të iniciuar me padi t'a përfundoj me tërheqje të padisë apo me heqje dorë nga kërkesëpadia apo me pajtim gjyqësor-ujdi.

Dispozita e nenit 149 paragrafi 1 parasheh "Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë", ndërsa paragrafi 2 parasheh "Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur". Në këtë rast kemi të bëjmë me veprim procedural të palës paditëse dhe si i tillë i nënshtrohet dispozitave të LPK-së, përkatësisht nenit 149. Për dhënien e aktgjyimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia si kusht elementar është heqja dorë nga kërkesëpadia, në këtë rast pala paditëse e ka përdorur termin tërheqje në tërësi të padisë dhe kërkesëpadisë dhe këtë Gjykata e ka vlerësuar si heqje dorë nga kërkesëpadia. Aktgjykimi mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia Gjykata e nxjerrë pavarësisht se të njëjtin a e ka kërkuar pala paditëse apo jo, mjafton të heqë dorë nga kërkesëpadia. Në këtë rast Gjykata ka konstatuar se pala paditëse disponon lirisht me kërkesat për të cilat ka hequr dorë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.107/16, me datë 25.01.2018

Gjyqtari,

Misin Frangu



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

